



www.qbz.gov.al

# Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare



Viti: 2018 – Numri: 20

**Tiranë – E hënë, 7 maj 2018**

## PËRMBAJTJA

Faqe

Vendim i Gjykatës së  
Rrethit Gjyqësor Tiranë  
nr. 3244, datë 10.4.2018

Me objekt mbylljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Albanian Airlines”  
sh.p.k., me NIPT J61827030N, me administrator Yahia Farwati, me seli në  
Tiranë, adresa: sheshi “Avni Rustemi”, pallati “Teuta Construction”, kati i 1-rë...

3



## VENDIM

Nr. 3244, datë 10.4.2018

**NË EMËR TË REPUBLIKËS  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
TIRANË, E PËRBËRË NGA:  
MARINELA OSMANI – GJYQTARE**

Asistuar nga sekretare gjyqësore **Valbona Maja**, sot në datën 10.4.2018, përfundoi shqyrtimin në dhomë këshillimi, çështjen tregtare nr. 392, që i përket:

**KËRKUESE: Shpresa Breçani**, administratore e falimentimit e shoqërisë “Albanian Airlines” sh.p.k., në falimentim.

**OBJEKTI:** Mbyllja e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Albanian Airlines” sh.p.k., me NIPT J61827030N, me administrator Yahia Farwati, me seli në Tiranë, adresa: sheshi “Avni Rustemi”, pallati “Teuta Construction”, kati i 1-rë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 3, 4, 5, 6, 7, 8, 163 e vijues, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, i ndryshuar.

**Gjykata**, në përfundim të shqyrtimit si më lart, pasi realizoi mbledhjen përfundimtare të kreditorëve të falimentimit dhe dëgjoi ata dhe administratoren e falimentimit të shoqërisë “Albanian Airlines” sh.p.k., në falimentim, në lidhje me vijimësinë e procedurës dhe shqyrtoi çështjen në tërësi;

## VËREN:

1. Shoqëria “Albanian Airlines” sh.p.k. është një shoqëri tregtare e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit Tiranë, në datën 16.5.1995. Kjo shoqëri ka ushtruar aktivitetin tregtar në fushën e transportit ajror të mallrave e të pasagjerëve me mjetet e transportit ajror, të blera prej saj, si dhe të marra ose dhëna me qira të tyre, veprimtari të agjencisë të udhëtimit e shitjes së biletave, aktivitet magazinues e spedicioner, si dhe administrim e operim e akomodim i pasurive të paluajtshme në aeroporte që i shërbejnë kësaj veprimtarie, veprimtari riparuese, pastruese e magazinuese avionësh ose pajisje të tyre, veprimtari cateringu (përgatitja dhe furnizimi me ushqime dhe pije) dhe/ose ajo e Self Catering-ut (vetfurnizim).

2. Me vendimin nr. 3678, datë 21.4.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka vendosur:

- Pranimin e kërkesës së kërkuarit shoqëria “Havas –Havaalanlari Yer Hizmetleri A. S.” sh.p.k.

- Hapjen në orën 14:00, të datës 21.4.2016, të procedurës së falimentimit të shoqërisë “Albanian Airlines” sh.p.k., me administrator Yahia Farwati, me seli në adresën: sheshi “Avni Rustemi”, pallati “Teuta Construction”, kati i 1-rë, Tiranë, Shqipëri

- Emërimin si administratore të falimentimit, për shoqërinë “Albanian Airlines” sh.p.k., të znj. Shpresa Breçani, e licencuar nga Ministria e Drejtësisë, me licencën nr. 9, datë 14.10.2014, me adresë: rruga “Jordan Misja”, P. Sara El, shk. 1, ap.1, Tiranë.

3. Gjatë zhvillimit të procedurës janë mbajtur mbledhja për raportim dhe mbledhja për verifikimin e pretendimeve, të cilat kanë përfunduar me miratimin e tabelave përkatëse të pretendimeve të kreditorëve të shoqërisë “Albanian Airlines” sh.p.k.

4. Me shkresën nr. 652 prot. datë 11.2.2018, nga ana e Gjykatës i është kërkuar administratores një informacion për procedurën dhe njëkohësisht kryerja e veprimeve të caktuara. Në kuadër të këtyre veprimeve rezultoi se është dhe mbledhja e Komitetit të Kreditorëve, të datës 16.2.2018, e cila ka miratuar një ndryshim në radhën e preferimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

5. Nga ana e administratores së falimentimit, me shkresën e depozituar me nr. 559 prot., datë 2.3.2018 është vënë në dispozicion tabela e shpërndarjes përfundimtare për masën e falimentimit në shumën 11,319,535 lekë. Me njoftim paraprak dhe më pas me shkresën nr. 6095 prot., datë 9.3.2018, administratorja e falimentimit ka depozituar tabelën përfundimtare të shpërndarjes në shumën 10,283,982 lekë, që ka rezultuar si rrjedhojë e ndryshimeve të kursit të këmbimit të dollarit në datë 8.3.2018 në llogarinë e Bankës Kombëtare Tregtare.

6. Me vendimin nr. 392 akti, datë 9.3.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur:

1) Pranimin e kërkesës.

2) Miratimin e shpërndarjes përfundimtare të masës së falimentimit në shumën 10,283,982 lekë, sipas shumave dhe radhës së preferimit të vendosur për çdo kreditor, sipas tabelës së paraqitur nga administratorja e falimentimit e shoqërisë “Albanian Airlines” sh.p.k., në falimentim, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.

3) Shpërndarja e masës së falimentimit, sipas tabelës së miratuar, do të bëhet nga administratorja e falimentimit e shoqërisë “Albanian Airlines”



sh.p.k., në falimentim, pas diskutimit të vërejtjeve sipas neneve 160 dhe 157 të ligjit, në mbledhjen përfundimtare të kreditorëve të falimentimit, në afatet dhe mënyrën që do të caktohet nga Gjykata në këtë mbledhje.

4) Caktimin e mbledhjes përfundimtare të kreditorëve të falimentimit, e cila do të mbahet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datë 29.3.2018, ora 11:00, kati i tretë, sala nr. 5. Mbledhja përfundimtare e kreditorëve të falimentimit do të ketë si rend dite:

a) Diskutimin e llogarive të paraqitura nga administratori i falimentimit;

b) Paraqitjen e vërejtjeve ndaj listës përfundimtare të shpërndarjes;

c) Diskutim mbi vijimësinë e procedurës.

5) Anëtarët e Komitetit të Kreditorëve kanë të drejtë të paraqesin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, komentvërejtjet në lidhje me llogaritë përfundimtare të paraqitura nga administratorja, brenda 7 ditëve nga dita e njoftimit të këtij vendimi. Mospërmbushja e këtyre kritereve formale i bën vërejtjet të papranueshme për shqyrtim.

6) Kreditorët e falimentimit kanë të drejtë të paraqesin me shkrim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, deri në 7 ditë para datës së caktuar, sipas pikës 3 të këtij vendimi, vërejtjet ndaj listës përfundimtare të shpërndarjes, nëse ata kanë. Nëse kreditori i falimentimit është person juridik, kërkesës me shkrim duhet t'i bashkëlidhet një ekstrakt lëshuar nga QKB-ja (në origjinal) dhe një autorizim të posaçëm lëshuar nga administratori për përfaqësuesin. Mospërmbushja e këtyre kritereve formale e bën kërkesën të papranueshme për shqyrtim.

7) Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet personalisht administratores së falimentimit Shpresa Breçani.

8) Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet nga administratorja e falimentimit Shpresa Breçani, personalisht 4 anëtarëve të Komitetit të Kreditorëve.

9) Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet nga administratorja e falimentimit personalisht kreditorëve të falimentimit dhe debitorit shoqërisë "Albanian Airlines" sh.p.k., në falimentim.

10) Një kopje e këtij vendimi të shpallet publikisht në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për efekt njoftimi publik.

7. Në datën 29.3.2018 u mbajt mbledhja përfundimtare e kreditorëve, në të cilën u diskutuan llogaritë e paraqitura nga administratorja e falimentimit dhe u kërkuu paraqitja e vërejtjeve lidhur me të dhe listën përfundimtare.

8. Në datë 23.3.2018, nga ana e kreditorit të falimentimit shoqëria "Intesa San Paolo Bank Albania" sh.a., është paraqitur kërkesa e depozituar me nr. 7104 prot., me objekt vërejtje ndaj listës përfundimtare të shpërndarjes.

9. Sipas kësaj kërkesë, Banka si anëtare e Komitetit të Kreditorëve të shoqërisë në falimentim "Albanian Airlines" sh.p.k., pretendon se është informuar nga administratorja e falimentimit se Gjykata e Falimentimit, ka vendosur në datën 9.3.2018, të miratojë shpërndarjen e të ardhurave nga shitja e masës së falimentimit. Shpërndarja u bë bazuar në vendimin e Komitetit të Kreditorëve më 16 shkurt 2018, ku u vendos të përfshihej edhe pretendimi i punëmarrëses Suela Beliu (trashëgimtarit të saj Ramazan Beliu). Ramazan Beliu, trashëgimtar i punëmarrëses së ndjerë, përfitoi në radhë të parë nga shpërndarja shumë prej 2,017,200 lekë.

10. Kreditori i falimentimit pretendon se është kundër kësaj shpërndarjeje, duke paraqitur të njëjtin qëndrim që ka mbajtur në Komitetin e Kreditorëve në mbledhjen e datës 16 shkurt 2018. Sipas tij, kreditori Ramazan Beliu duhet të trajtohet sipas germës "ë" të nenit 605 të Kodit Civil. Dokumentacioni i paraqitur nga ky kreditor, vendimi i gjykatës që ka vendosur t'i njohë atij dëmshpërblimin me 24 paga në total, provon faktin se ky pretendim duhet të radhitet sipas germës ë) të nenit 605 të Kodit Civil.

11. Me vendimin nr. 392 akti, datë 29.3.2018, Gjykata ka vendosur:

1) Rrëzimin e kërkesës së kreditorit të falimentimit shoqëria "Intesa San Paolo Bank" sha, si të pabazuar në prova dhe në ligj.

2) Kundër këtij vendimi, kreditori i falimentimit shoqëria "Intesa San Paolo Bank" sh.a. ka të drejtën e ankimit të veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

12. Gjatë procedurës së falimentimit, në referim të nenit 17 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 "Për falimentimin", i ndryshuar, nga ana e administratores së përkohshme të



falimentimit të shoqërisë “Albanian Airlines” sh.p.k., shoqëri në falimentim, është kërkuar informacion në rrugë zyrtare nga institucionet e kredisë, institucionet e Regjistrimit të Pasurive të Luajtshme dhe të Paluajtshme, në zyrën përmbartimore “Strati Bailif Service”, si dhe në institucione të tjera në funksion të dhënies së informacionit të nevojshëm për procedurën e falimentimit.

13. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur me vendimin nr. 3678 akti, datë 1.4.2016 pranimin e kërkesës si dhe vendosjen e masës së sigurimit mbi sendet e luajtshme dhe pezullimin e veprimeve përmbartimore të shoqërisë “Strati Bailif Service” sh.p.k. Me shkresën datë 8.6.2016, administratorja i është drejtuar shoqërisë përmbartimore “TDR Group” sh.p.k., me objekt “Komunikim vendimi dhe kërkesë për pezullimin e veprimeve mbi asetet e shoqërisë “Albanian Airlines” sh.p.k.”, pasi u informua se kjo shoqëri kishte filluar procedurën për ekzekutimin e aseteve të shoqërisë.

14. Sipas raportit të administratores, rezulton se me shkresën datë 13.5.2016, referuar dhe ekstraktit historik nga QKB-ja, ajo i është drejtuar administratorit të shoqërisë z. Yahia Farwati për dorëzimin e të gjithë dokumentacionit të shoqërisë dhe dorëzimin e masës së falimentimit me inventar fizik, tek Administratorja e falimentit. Me shkresë datë 2.6.2016, z. Farwati është përgjigjur se nuk disponon asnjë dokumentacion, për sa i përket Shoqërisë “Albanian Airlines” sh.p.k., pasi ky dokumentacion është disponuar nga shoqëria “Evsen Group”, me administrator Z. Firidun Goyushov, përpara se ky i fundit të merrte shoqërinë. Me vendimin nr. 1036, datë 8.2.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Z. Farwati përgjigjet se informacioni i kërkuar mund të kërkohej në institucionet shtetërore përkatëse, duke mos paraqitur asnjë informacion apo dokumentacion.

15. Lidhur me asetet e shoqërisë “Albanian Airlines” sh.p.k., nga verifikimet e kryera, pavarësisht se nga Autoriteti Rrugor, rezultonte se kishte 11 automjete të regjistruara në emër të kësaj shoqërie, fizikisht nuk është gjendur asnjë prej këtyre aseteve. Për këtë arsye, administratorja i është drejtuar të gjitha komisariateve të Policisë së Tiranës në rrugë

shkresore, për bllokimin fizik të këtyre automjeteve në rast të evidentimit nga ana e tyre.

16. Për të kërkuar në vazhdimësi gjatë procedurës së falimentimit asetet e kësaj shoqërie në falimentim në detyrën e administratores së falimentimit janë lidhur kontrata shërbimi me shoqërinë përmbartimore “JUS” sh.p.k., ku nga informacioni i sjellë nga kjo zyrë, rezultoi se 11 automjetet e regjistruara në emër të shoqërisë “Albania Airlines” sh.p.k., ishin shitur të tretëve para çeljes së procedurës së falimentimit që në vitin 2012.

17. Asete të evidentuara fizikisht, rezultuan, sipas raportit, vetëm katër mjete të transportit ajror, një magazinë e ndërtuar, jo në truallin e saj, brenda ambienteve të “Tirana International Airport”, si dhe një automjet tip “Kamionçine Peugeot”. Tri nga këto asetet kanë rezultuar të regjistruar në Regjistrin e Barrave Siguruese në favor të kreditorit “Intesa San Paolo Bank” sh.a., ku nga pretendimet e paraqitura, rezulton i vetmi kreditor i siguruar.

18. Në zbatim të nenit 133 “E drejta e disponimit” të ligjit për falimentimin, nga administratorja e falimentimit është bërë vlerësimi i mjeteve të transportit ajror, ku është përcaktuar nëse do të ishte në kushtet e veçimit apo ekzekutimit të këtyre aseteve brenda procedurës së falimentit. Është kërkuar nga administratorja një vendimmarrje nga kreditori i siguruar “Intesa San Paolo Bank” sh.a. për veçimin e sendit dhe pagimin e shpenzimeve të përcaktimit në masën 4% të vlerës së kolateralit sipas përcaktimeve ligjore.

19. Në përgjigje të kërkesës, kreditori “Intesa San Paolo Bank” sh.a., me shkresën nr. prot. 17/26291, datë 24.5.2017, i ka dhënë të drejtën administratores së falimentimit “të drejtën për shitjen e kolateralit”, mbi të cilat ka vendosur barrë siguruese, duke u shprehur se nuk hiqte dorë nga e drejta e ripagimit të veçantë, duke pretenduar të ishte kreditor i siguruar me të drejtë ripagimi të veçantë, por pa ushtruar të drejtën e veçimit, sipas nenit 133 të ligjit.

20. Mënyra e shitjes së masës së falimentimit është përcaktuar në vendimin e Gjykatës së falimentimit, me nr. Rregj. Them. 3678, datë 7.11.2016 “Mbi vazhdimin e procedurës së falimentimit për miratimin e pretendimeve përfundimtare të kreditorëve të miratuar nga



Gjykata dhe miratimin e mënyrës së shitjes së aseteve të shoqërisë në proces falimentimi” si dhe me vendimin e Komitetit të Kreditorëve, më datë 13.9.2016 për shitjen pjesë-pjesë të masës së falimentimit për krijimin e fondeve të likuiditeteve.

21. Në kushtet kur ka përfunduar shitja e masës së falimentimit dhe është depozituar shuma në llogarinë bankare të shoqërisë “Albanian Airlines” sh.p.k., shoqëri në falimentim, shumë e cila është shpërndarë sipas dispozitave që përcakton ligji, në detyrën e administratorës së falimentimit, u kërkua përfundimi i procedurës së falimentimit, pasi është kryer shpërndarja përfundimtare nga seksioni tregtar i gjykatës së rrethit.

22. Bazuar në nenin 163 të ligjit për falimentimin, sipas të cilit: *“Sapo të jetë kryer shpërndarja përfundimtare, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos mbylljen e procedurës së falimentimit. Vendimi dhe shkakun i mbylljes shpallen publikisht.”*

23. Në nenin 1, të ligjit për falimentimin, përcaktohet se: *“Procedura e falimentimit ka për qëllim të shlyejë në mënyrë kolektive detyrimet e debitorit nëpërmjet likuidimit të të gjitha pasurive të tij dhe shpërndarjes së të ardhurave ose në rastin e një plani riorganizimi nëpërmjet arritjes së një marrëveshje tjetër me synimin kryesor ruajtjen e veprimtarisë së tij.”*

24. Nga përmbajtja e këtij neni del qartë se janë njohur dhe pranuar dy mënyra të shlyerjes kolektive të detyrimeve të debitorit: a) nëpërmjet likuidimit të të gjitha pasurive dhe shpërndarjes së të ardhurave; b) nëpërmjet plan riorganizimit/ një marrëveshje, që synon ruajtjen e veprimtarisë së debitorit. Nga përcaktimi i këtij neni Gjykata çmon në rastin konkret objekt gjykimi nuk ndodhemi përpara një plani riorganizimi i cili u nënshtrohet rregullimeve të parashikuara konkretisht në këtë ligj, por shlyerjes në mënyrë kolektive të detyrimeve të debitorit nëpërmjet likuidimit të të gjitha pasurive të tij dhe shpërndarjes së të ardhurave.

25. Ligji i posaçëm dhe pse në nenin 1 të tij jep qëllimin e procedurës së falimentimit dhe mënyrat e realizimit të tij, nuk përcakton shprehimisht pasojat që vijnë nga likuidimi për shkak të falimentimit i debitorit/shoqërisë; nuk përmban dispozita të veçanta mbi pasojat për likuidimin për shkak falimentimi lidhur me vetë debitorin shoqëri, gjë e cila passjell dhe zbatimin

e dispozitave të ligjit tregtar mbi likuidimin e një shoqërie tregtare, për sa u përket pasojave (ligji për falimentimin parashikon vetëm shpërndarjen e të ardhurave dhe të drejtat e kreditorëve të falimentimit mbas mbarimit të procedurës së falimentimit sipas neneve 164–167).

26. Pavarësisht shkakut të likuidimit (vullnetar apo falimentim) në thelb qëndron e njëjta situatë: likuidim i të gjithë pasurisë së subjektit/shoqërisë dhe shpërndarjen e të ardhurave. Në ligjin për shoqëritë tregtare gjejmë të pasqyruar pasojat që vijnë nga likuidimi në përfundim të tij: prishja e shoqërisë dhe çregjistrimi i shoqërisë, pasi kemi të bëjmë me një subjekt që nuk mund të vazhdojë me aktivitetin e tij, të cilit tashmë i është likuiduar e gjithë pasuria dhe shpërndarë të ardhurat.

27. Pasoja, prishja e shoqërisë dhe çregjistrimi i shoqërisë nga likuidimi për shkak falimentimi është i parashikuar shprehimisht në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, me ndryshimet. Neni 99 i tij sipas të cilit përcaktohet se: *“1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet: b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;... 5. Prishja e shoqërisë, si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente për procedurat e falimentimit, kur, në përfundim të këtyre procedurave, të gjitha pasuritë e shoqërisë janë likuiduar për shlyerjen në mënyrë kolektive të detyrimeve ndaj kreditorëve apo kur gjykata kompetente për procedurat e falimentimit vendos rrëzimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurisë së shoqërisë për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit...”*

28. Nga ana tjetër, ligji nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”- neni 51, i ndryshuar, ligj i cili, gjithashtu, parashikon dhe rregullon edhe pasojat e çregjistrimit në nenin 53 të tij përcakton çregjistrimi me vendim gjyqësor: *“Subjekti mund të çregjistrohet në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë që vendos se subjekti prishet, mbaron apo nuk mund të ushtrojë më veprimtari. QKR-ja çregjiston kryesisht subjektin në bazë të vendimit gjyqësor përkatës, me anë të të cilit vendoset çregjistrimi i subjektit në vijim të ndjekjes së procedurave të likuidimit në rrugë gjyqësore, në rastet kur ligji parashikon procedura likuidimi për këto subjekte, ose në vijim të ndjekjes së procedurave të falimentimit apo të procedurave të tjera që mund të kërkojnë sipas ligjit.”*



## PËR KËTO ARSYE,

Gjykata bazuar në nenet 126, 306–308 të Kodit të Procedurës Civile, nenet 3, 4, 5, 6, 7, 8, 163 e vijues të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, i ndryshuar,

## VENDOSI:

1. Mbylljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Albanian Airlines” sh.p.k., me NIPT J61827030N, me administrator Yahia Farwati, me seli në Tiranë, adresa: sheshi “Avni Rustemi”, pallati “Teuta Construction”, kati i 1-rë.

2. Urdhërohet çregjistrimi i shoqërisë “Albanian Airlines” sh.p.k. nga Regjistri Tregtar i Shoqërive pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

3. Urdhërohet publikimi i vendimit për mbylljen e procedurave të falimentimit të debitorit shoqërisë “Albanian Airlines” sh.p.k., në Buletinin Zyrtar të Njoftimeve Publike.

4. Urdhërohet publikimi i këtij vendimi, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në adresën zyrtare në internet të këtij institucioni, në adresën zyrtare në internet të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

5. Një kopje e vendimit për mbylljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Albanian Airlines” sh.p.k., t’i dërgohet Qendrës Kombëtare të Biznesit.

6. Një kopje e vendimit për mbylljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Albanian Airlines” sh.p.k., t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si dhe Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

7. Një kopje e vendimit për mbylljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Albanian Airlines” sh.p.k., t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

8. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet personalisht administratorës së falimentimit Shpresa Breçani.

9. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet nga administratorja e falimentimit personalisht kreditorëve të falimentimit dhe debitorit shoqërisë “Albanian Airlines” sh.p.k., në falimentim.

10. Administratori i falimentimit dhe kreditori i falimentimit kanë të drejtë të paraqesin kërkesë para kësaj Gjykate për shpërndarje të vonuar në kushtet e nenit 166 dhe vijues të ligjit.

11. Shpenzimet gjyqësore janë në ngarkim të masës së falimentimit.

12. Kundër vendimit palët në procedurën e falimentimit kanë të drejtën e ankimit të veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar ose nga dita e nesërme e shpalljes publike në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës dhe në Buletinin Zyrtar të Njoftimeve Publike.

U shpall në Tiranë, sot në datën 10.4.2018.

SEKRETARE  
Valbona Maja

GJYQTARE  
Marinela Osmani

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.  
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

**Tiranë, 2018**